



MALI I ZI - CRNA GORA - MONTENEGRO

**KËSHILLI KOMBËTAR  
I SHQIPTARËVE**  
NACIONALNI SAVJET ALBANACA - ALBANIAN NATIONAL COUNCIL

Nr.84/25

Ulqin, më 16.07.2025

Subjekti: Letër urimi  
Prof.Dr. David Kalaj

I nderuar profesor Kalaj,

Me rastin e pranimi Tuaj në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, me lejoni që në emër të Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Malin e Zi dhe në emrin tim, t'ju përcjell urimet më të përzemërta për këtë arritje më se të merituar për punën, angazhimin dhe arritjet tuaja shkencore.

Lajmi i pranimi Tuaj në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë na ka gëzuar pa masë dhe e vlerësojmë si një moment të veçantë, i cili duhet të bëjë krenar çdo shqiptar e në veçanti ne në Mal të Zi.

Ndihemi me fat që një intelektual e shkencëtar nga shqiptarët në Mal të Zi tashmë bëhet pjesë e institucionit i cili është pedestal i mendjeve më të ndritura të kombit dhe arritjeve shkencore të shqiptarëve.

Uroj e besoj fort se kontributi juaj si anëtar i këtij institucioni do të jetë tejte i çmuar e po ashtu dëshiroj fort që ju të jeni ogur i mirë që edhe intelektualë e shkenctarë potencialë shqiptarë në Malin e Zi të bëhen pjesë e këtij institucioni prestigjoz.

Me respekt,

K R Y E T A R I

Faik Nika

